



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 2003 / 13

**MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT NR. 2002/5 MBI
THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE NË PRONËN E
PALUAJTSHME**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë sipas neneve 9.1.26, 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/19),

Duke marrë parasysh se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/22 mbi Shpalljen e Ligjit të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave në Pronën e Paluajtshme, shpalli Ligjin Nr. 2002/5, me kusht që Ligji Nr. 2002/5 do të hyjë në fuqi pas shpalljes së legjislacionit plotësues të paraparë për njoftimin e vërtetë publik dhe masat tjera ruajtëse për mbrojtjen e personave të drejtat e të cilëve mund të ndikohen me regjistrim,

Me këtë miratohet ky Ligj, si vijon:

Neni 1

Në Ligjin nr. 2002/5, për themelimin e regjistrimit të të drejtave në pronën e paluajtshme pikat 3.3.a, 3.3.b dhe 3.3.c do të shtohen në fund të paragrafit 3.3:

3.3.a Çdo ZKK do të mbaj tabelën e shpalljeve publike ku do të afishohen kërkesat për regjistrim. Tabela e shpalljeve do të vendoset në vend të sigurt që është e arritshme dhe e dukshme për publikun gjatë orarit zyrtar të punës.

3.3.b Të paktën pesë (5) ditë pune para nxjerrjes së vendimit që lejon regjistrimin, ZKK do të afishoj njoftimin e kërkesës për regjistrim në tabelën e shpalljeve publike. Njoftimi do të përmbaj:

- i. adresën e pronës, dhe nëse është e mundur, numrin e ngastrës kadastrale;
- ii. të dhënat për personin prej të cilit bëhet bartja e të drejtës mbi pronën;

- iii. të dhënat për personin që me regjistrim e fiton të drejten mbi pronën;
- iv. e drejta që duhet të regjistrohet; dhe
- v. datën deri kur çdo palë e interesuar mund të paraqet kundërshtimin të ZKK (që do të jetë data e së paku pesë (5) ditë pune pas datës së afishimit në tabelen e shpalljeve publike).

3.3.c Para regjistrimit të çdo të drejte në ndërtesë apo banesë, ZKK do të bëjë një hetim të organi i duhur i Drejtorisë për Çështje Banesore dhe të Strehimit për të vërtetuar nëse është bërë kërkesë kundër ndërtesës apo banesës sipas Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/60 ose Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe ZKK do të vendosë:

- i. Të regjistroj të drejtën mbi pronën nëse nuk është bërë asnjë kërkesë, dhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesave ka kaluar;
- ii. Nëse kërkesa është bërë, ZKK do të refuzoj regjistrimin derisa të zgjidhet kërkesa nga komisioni i kërkesave pronësore dhe banesore; dhe
- iii. Nëse nuk është bërë kërkesa dhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nuk ka kaluar, ZKK do të fut në regjistrim vërejtjen vijuese:

Me këtë njoftim bëhet me dije se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave sipas Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 1999/23 ose 2000/60 nuk ka kaluar që nga regjistrimi i kesaj të drejte. Megjithatë është e mundur që regjistrimi t'i nënshtrohet kërkesës në të ardhmen. Sugjerohet që çdo palë e interesuar të kërkoj ndihmë juridike profesionale për të vlerësuar rrezikun e kërkesës së bërë.

Neni 2 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuar.

Ligji nr. 2003 / 13
26 Qershor 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci